

V E N D I M
Nr.314, datë 12.5.2001

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.8, DATË 13.1.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.378, DATË 12.8.1999 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PËRFAQËSUESIT TË PRONARIT
PËR DISA OBJEKTE, PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të ligjit nr.8482, datë 10.5.1999 “Për një shtesë në ligjin nr.7926, datë 10.5.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare””, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Nga lista e shoqërive dhe ndërmarrjeve, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.8, datë 13.1.2000 të Këshillit të Ministrave, hiqet objekti “Uzina kimike e ushtrisë”, me numër rendor 58, i cili i mbetet Ministrisë së Mbrojtjes, për plotësimin e nevojave të saj, në kuadër të ristrukturimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta